UDHËZIM
Nr. 4188, datë 1.9.2016

PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE NË SHOQËRITË E KURSIM-KREDITIT

Në bazë dhe për zbatim të pikës 5, shkronja "b", të nenit 53, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar; nenit 53, pika 4, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, Banka e Shqipërisë, me propozim të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave,

UDHËZON:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i kushteve, procedurës dhe afateve në lidhje me:

a) anëtarësimin e shoqërive të kursim-kreditit në skemën e sigurimit të depozitave;

b) vlerësimin e shumës së depozitës së siguruar dhe shumës së kompensimit, kontributet dhe primet e sigurimit;

c) shkëmbimin e informacionit, procesin e verifikimit dhe informimin e publikut;

d) përcaktimin e përmbajtjes së informacionit, parimeve dhe rregullave për funksionimin e Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, si dhe kushteve dhe kritereve për njohjen dhe përdorimin e informacionit që administrohet në të;

e) marrjen e masave ndaj shoqërive të kursim-kreditit në rast të mospërmbushjes së dispozitave ligjore dhe nënligjore të sigurimit të depozitave, përfundimin e sigurimit të depozitës dhe përja-shtimin e shoqërive të kursim-kreditit nga skema e sigurimit të depozitave.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky udhëzim zbatohet për të gjitha subjektet që kërkojnë të licencohen si SHKK-ja ose që janë licencuar nga Autoriteti Mbikëqyrës për të ushtruar veprimtari si shoqëri kursim-krediti në Republikën e Shqipërisë në përputhje me ligjin nr. 52/2016, datë 19.5.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre", dhe/ose çdo ligj ndryshues i tij.

Neni 3
Baza ligjore

Ky udhëzim del në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar dhe të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndry-shuar.

Neni 4
Përkufizime

1. Për qëllime të interpretimit dhe zbatimit të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "Sistemi Informatik për Raportim dhe Kompensim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave" ka të njëjtin kuptim me termin e përkufizuar në pikën 4, të nenit 26, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depo-zitave", të ndryshuar.

b) "Të dhëna personale" janë të dhënat e përkufizuara si të tilla në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.

c) "Përpunimi i të dhënave" nënkupton të gjitha veprimet në lidhje me marrjen, kontrollin, përpu-nimin dhe transferimin e të dhënave personale dhe informacionit/të dhënave të tjera lidhur me depozituesit dhe depozitat.

ç) "*Fallback-Recovery*" është procedura e kthimit të sistemit informatik për raportim dhe kompensim në një situatë normale, pasi ka pasur një dështim të funksionimit të sistemit parësor.

d) "*Sistem backup*" është tërësia e *hardware*-ve dhe *software*-ve që shërben në situata emergjente, të jashtëzakonshme, kur sistemi parësor del jashtë funksionimit.

dh) "Skedar" është dokumenti elektronik në formatin tekst (txt), i cili përmban të dhënat e raportuara.

e) "Përdorues i sistemit" janë shoqëritë e kursim-kreditit anëtare të skemës, Agjencia, kujdestari dhe likuidatori, sipas dispozitave të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me:

a) përkufizimet e përcaktuara në nenin 3, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar.

b) përkufizimet e nenit 3, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre" dhe/ose çdo ligj ndryshues i tij.

3. Në kuptim të termit "depozitë" të nenit 3, pika 13, shkronja "b", të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar, nuk përfshihen kontributet e anëtarëve në kapitalin e SHKK-së.

4. Për të gjitha çështjet që nuk rregullohen në mënyrë specifike në këtë udhëzim, do të zbatohen dispozitat ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në fuqi.

KREU II
ANËTARËSIMI NË SKEMËN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Neni 5
Kushtet për t'u anëtarësuar në skemën e sigurimit të depozitave

1. Për anëtarësimin në skemë SHKK-të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) kushtin për krijimin dhe zotërimin e ligjshëm të zyrave për çdo SHKK, në pronësi të tyre ose me qira, të cilat minimalisht të mundësojnë shërbimin e arkës dhe veprimet me klientët, duke garantuar sigurinë fizike të tyre. SHKK-të duhet të kenë një rregullore të brendshme për menaxhimin e parasë në arkë dhe sigurinë e tyre fizike;

b) kushtin e aftësimit profesional të personelit dhe organeve drejtuese lidhur me zbatimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor për sigurimin e depozitave;

c) kushtin për administrimin e aktivitetit operacional të SHKK-së, që përfshin: mbajtjen e dosjeve për kontratat e depozitave dhe kredive, dokumentacionin kontabël, sistemet kompjuterike të kontabilitetit, etj. SHKK-të duhet të kenë një rregullore të brendshme për veprimet e tyre operacionale;

d) kushtin për mbajtjen e saktë të të dhënave për depozitat dhe depozituesit në format shkresor dhe elektronik me qëllim identifikimin e depozi-tuesit me një individ, tregtar dhe shoqëri tregtare konkrete dhe përcaktimin e saktë të shumës që SHKK-ja i detyrohet këtij depozituesi. Këto të dhëna duhet të regjistrohen dhe të përditësohen në sistemin elektronik të SHKK-së në kohë reale, nga momenti i kryerjes së veprimit me depozituesin, në të gjithë rrjetin e degëve të saj;

e) kushtin teknik për krijimin e sistemeve elektronike, të cilat mundësojnë në çdo kohë ruajtjen dhe gjenerimin e të dhënave për depozitat, depozituesit dhe huat. Këto sisteme përpunojnë të dhëna për depozituesit dhe depozitat në funksion të identifikimit unik të depozituesit, të vlerësimit të shumës së depozitës së siguruar, të përllogaritjes së primit tremujor dhe të vlerësimit të shumës së kompensimit, sipas kërkesave të përcaktuara në këtë udhëzim;

f) kushtin e informimit të publikut për dhënien e informacionit të saktë dhe të plotë mbi skemën e sigurimit të depozitave sipas kërkesave të përcak-tuara në aneksin 8 të këtij udhëzimi;

g) kushtin e gjendjes financiare gjatë vitit të parë të anëtarësimit të SHKK-së në skemë. Për plotësimin e këtij kushti, SHKK-të duhet të dëshmojnë se kanë gjendje financiare, e cila siguron vazhdimësinë e veprimtarisë. Për SHKK-të që janë licencuar nga Autoriteti Mbikëqyrës përpara miratimit të këtij udhëzimi, vlerësimi i gjendjes financiare do të bëhet në bazë të treguesve të zbatueshëm nga Autoriteti Mbikëqyrës lidhur me nivelin e kapitalit, rezultatin financiar dhe nivelin e kredive me probleme. Për SHKK-të e reja, vlerësimi i gjendjes financiare do të bëhet në bazë të planit të veprimtarisë/biznesit, sipas aneksit 1, formularit 6, të këtij udhëzimi;

h) kushtin e plotësimit të parimeve kryesore të drejtimit të përgjegjshëm, si për shembull: ndarjen e funksioneve dhe përgjegjësive, shmangien e kon-fliktit të interesit, funksionimin e një komiteti kontrolli efektiv etj.;

i) kushtin e pagesës së kontributit fillestar;

j) kushtin e pjesëmarrjes në simulime për kryerjen e procesit të kompensimit, sipas kërkesës dhe nevojës së Agjencisë dhe në përputhje me aktet nënligjore të miratuara për këtë qëllim;

k) kushtin për raportimin e të dhënave mbi depozitat dhe depozituesit në mënyrë shkresore dhe elektronike pranë Agjencisë. Raportimi elektronik i të dhënave përputhet me të dhënat shkresore sipas kërkesave të këtij udhëzimi.

2. SHKK-të e anëtarësuara në skemë, duhet të plotësojnë kushtet e parashikuara sipas këtij neni gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Neni 6

Kërkesa për anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave

1. Subjektet që kanë paraqitur kërkesë për licencim, si SHKK pranë Autoritetit Mbikëqyrës, paraqesin njëkohësisht në Agjenci kërkesën për anëtarësimin në skemë, sipas aneksit 1 të këtij udhëzimi, si dhe planin e veprimeve për përmbu-shjen e kushteve, njëkohësisht me dorëzimin në Autoritetin Mbikëqyrës të kërkesës për licencë si SHKK.

2. Dokumentacioni i kërkuar në këtë nen duhet të jetë në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar.

3. Kur dokumentacioni i paraqitur nuk përputhet me kërkesat e këtij udhëzimi, si dhe kur nuk plotësohen kushtet të përcaktuara në nenin 5 të tij, Agjencia njofton me shkrim subjektin në lidhje me mangësitë, papajtueshmërinë apo për informacion shtesë, brenda dhjetë ditësh pune nga evidentimi i tyre.

4. Agjencia kryen verifikimin në vend të plotë-simit të kushteve nga subjekti, si dhe mund të kërkojë informacion shtesë.

5. Mangësitë e gjetura dhe vërejtjet e bëra në lidhje me zbatimin e këtij udhëzimi, korrigjohen nga subjekti brenda një muaji nga dita e marrjes së njoftimit nga Agjencia. Në rast të plotësimit të kushteve, mangësive dhe vërejtjeve të bëra, Agjencia njofton SHKK-në për pranimin e kërkesës për shqyrtim dhe pagesën e kontributit fillestar.

6. SHKK-ja, brenda tri ditëve pune nga marrja e njoftimit, bën pagesën e kontributit fillestar.

7. Këshilli Drejtues i Agjencisë vendos për refuzimin ose dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave pas arkëtimit të kontributit fillestar.

8. Agjencia, jo më vonë se shtatë ditë kalen-darike nga data e vendimit të Këshillit Drejtues të Agjencisë për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore, lidhur me siguri-min e depozitave, njofton subjektin dhe dërgon në Autoritetin Mbikëqyrës këtë vendim.

9. Agjencia dhe Autoriteti Mbikëqyrës bashkë-punojnë gjatë licencimit dhe anëtarësimit të subjekteve në skemë.

Neni 7

Vendimi për anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave

1. Autoriteti Mbikëqyrës, në çdo rast, licencon subjektin, që kërkon të veprojë si SHKK, pasi ka marrë vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave.

2. Këshilli Drejtues miraton vendimin për anëtarësimin e subjektit në skemën e sigurimit të depozitave pas licencimit të subjektit nga ana e Autoritetit Mbikëqyrës brenda 3 ditësh pune nga marrja e njoftimit me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës.

3. Agjencia njofton brenda tri ditëve nga marrja e vendimit sipas pikës 2 të këtij neni, subjektin për anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave, duke i njoftuar datën, vendin dhe orën e dhënies së certifikatës për sigurimin e depozitave.

4. SHKK-ja e sapolicencuar, anëtare e skemës së sigurimit të depozitave, njofton me shkrim Agjencinë për datën e fillimit të veprimtarisë së saj.

Neni 8

Publikimi i vendimit për pranim, regjistrimi dhe dhënia e certifikatës

1. Vendimi për anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave për subjektet e këtij udhëzimi botohet në Fletoren Zyrtare dhe të paktën në një gazetë kombëtare me tirazhin më të madh.

2. SHKK-ja publikon certifikatën e sigurimit të depozitave në një vend të dukshëm, në mjediset ku ajo ushtron aktivitetin në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Agjencia mban një regjistër të disponueshëm për konsultim nga publiku, ku regjistrohen të gjitha certifikatat e dhëna për sigurimin e depozitave.

4. Regjistri përmban minimalisht informa-cionin/dokumentet e mëposhtëm:

a) një kopje të certifikatës;

b) emërtimin e SHKK-së;

c) një kopje të vendimit të Këshillit Drejtues për pranimin e SHKK-së në skemë;

Neni 9

Pajisja me certifikatë për sigurimin e depozitave në rast të ndryshimit të emrit

1. Në rast të ndryshimit të emrit, SHKK-ja paraqet në Agjenci kërkesën, sipas aneksit 2 të këtij udhëzimi,

për t'u pajisur me certifikatë të re. Kërkesa shoqërohet me vendimin e organit përkatës të subjektit për ndryshimin e emrit, kopje të ekstraktit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit me reflektimin e ndryshimit të emrit dhe një kopje të licencës së Autoritetit Mbikëqyrës me emrin e ndryshuar.

2. Agjencia, nëse e gjykon të nevojshme, mund të kërkojë nga subjekti informacion shtesë përveç atyre të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, si dhe përmbushjen e kushteve të tjera të nevojshme.

3. Këshilli Drejtues i Agjencisë miraton ndryshimin në certifikatën e sigurimit të depozitave jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës për ndryshimin e certifikatës.

4. Agjencia, brenda shtatë ditëve kalendarike nga miratimi i ndryshimit të certifikatës, njofton subjektin për vendimin e Këshillit Drejtues për ndryshimin dhe tërheqjen e certifikatës për sigurimin e depozitave.

5. Certifikata e re mban datën e vendimit të Këshillit Drejtues për pasqyrimin e ndryshimit të emrit.

6. Në çdo rast, Agjencia pajis SHKK-në me certifikatën e re për sigurimin e depozitave, vetëm kundrejt dorëzimit prej saj të certifikatës së mëparshme.

Neni 10

Anëtarësimi në skemën e sigurimit të depozitave në rast riorganizimi të SHKK-së

1. Në rast se riorganizimi i SHKK-ve të pranuara në skemën e sigurimit të depozitave, bëhet duke krijuar një SHKK të re, atëherë subjektet që do të bashkohen paraqesin kërkesën për anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave të SHKK-së së re, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

2. Subjektet e interesuara dorëzojnë në Agjenci dokumentacionin e mëposhtëm në të njëjtën kohë me paraqitjen në Autoritetin Mbikëqyrës të kërkesës për miratimin e bashkimit të SHKK-ve:

a) aneksin 1 të këtij udhëzimi;

b) aneksin 2 të këtij udhëzimi;

c) vendimet e asambleve përkatëse.

3. SHKK-të, të cilave iu revokohet licenca, dorëzojnë në Agjenci një kopje të vendimit të Autoritetit Mbikëqyrës për revokimin e licencave individuale të SHKK-ve, si dhe certifikatat e sigurimit të depozitave.

4. Në rast se riorganizimi i SHKK-ve të licencuara bëhet me përthithje, atëherë SHKK-ja përthithëse, paraqet kërkesën për përfshirjen e depozitave të siguruara të SHKK-së që do të përthithet, të cilës do t'i revokohet licenca e Autoritetit Mbikëqyrës, në depozitat e SHKK-së përthithëse, në përputhje me pikën 2 të këtij neni.

5. Agjencia vlerëson nëse SHKK-ja, mbi bazën e së cilës është bërë riorganizimi, plotëson kushtet për përfshirjen e depozitave të siguruara të SHKK-së, së cilës do t'i revokohet licenca nga ana e Autoritetit Mbikëqyrës.

6. Agjencia i dërgon një vërtetim Autoritetit Mbikëqyrës në lidhje me plotësimin e kushteve nga SHKK-ja mbi bazën e të cilit është bërë riorganizimi. Autoriteti Mbikëqyrës miraton ose refuzon riorganizimin e SHKK-ve pas marrjes së opinionit të Agjencisë.

7. SHKK-ja përthithëse paraqet në Agjenci një kopje të vendimit të Autoritetit Mbikëqyrës për refuzimin ose miratimin e riorganizimit, si dhe një kopje të vendimit për revokimin e licencës së SHKK-së përkatëse.

8. SHKK-ja e riorganizuar paguan kontributin fillestar sipas nenit 13 të këtij udhëzimi. Këshilli Drejtues mund të vendosë përjashtimin nga detyrimi për pagesën e kontributit fillestar për subjektet, të cilat krijohen duke marrë përsipër depozitat dhe detyrimet e një subjekti anëtar ekzistues.

9. Në çdo rast riorganizimi, Agjencia pajis SHKK-në me certifikatën e re për sigurimin e depozitave vetëm pasi kjo e fundit të ketë dorëzuar pranë saj certifikatën e mëparshme.

10. Dispozitat e këtij udhëzimi janë të zbatueshme edhe për subjektet që përfshihen në shndërrimin e unionit në SHKK.

KREU III

VLERËSIMI I SHUMËS SË DEPOZITAVE TË SIGURUARA DHE SHUMËS SË KOMPENSIMIT, KONTRIBUTET DHE PRIMET E SIGURIMIT

Neni 11

Sigurimi i depozitave

1. Agjencia siguron depozitat e individëve, tregtarëve dhe shoqërive tregtare në SHKK-të e pranuara në skemën e sigurimit të depozitave, bazuar në:

a) kontratën e depozitës;

b) librezën e kursimit;

c) kartelën e depozitës;

ç) dokumentet kontabël;

d) të dhënat e regjistrit elektronik.

2. Sigurimi i depozitës përfundon, kur:

a) depozita klasifikohet si depozitë e pasiguruar;

b) depozita kompensohet nga Agjencia si pasojë e likuidimit të detyruar të SHKK-së.

3. Në rastin e likuidimit vullnetar të SHKK-së, depozitat mbeten të siguruara deri në përfundimin e këtij procesi.

4. Në rastet e riorganizimit, depozitat e siguruara të SHKK-ve pjesëmarrëse mbeten të siguruara për çdonjërën prej tyre tre muaj pas datës në të cilën Agjencia njoftohet me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për përfundimin e procesit të riorganizimit.

5. SHKK-të zbatojnë nenin 26, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar nëpërmjet krijimit, mirëmbajtjes dhe funksionimit të sistemeve elek-tronike për mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave për vlerësimin e shumës së depozitave të siguruara në çdo kohë, sipas aneksit 9 "Vlerësimi i shumës së depozitave të siguruara" të këtij udhëzimi.

6. Shuma e depozitave të siguruara është vlera aritmetike që shërben si bazë për llogaritjen e primit dhe që rezulton nga zbatimi i hapave të mëposhtëm:

a) mbajtja e saktë e të dhënave personale të depozituesit dhe të depozitave të këtij depozituesi;

b) mbajtja e një numri të vetëm (kodit personal në sistem) të depozituesit, me qëllim që ai të identifikohet në mënyrë të saktë dhe pa përsëritje;

c) zbatimin e përjashtimeve nga skema e sigurimit të depozitave;

ç) përllogaritjen e interesit ditor për çdo depozitë të depozituesit;

d) konvertimin në lekë të depozitave në valutë, sipas kursit zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës;

dh) zbatimin e kushteve kontraktore që zba-tohen ndaj çdo depozite (sipas rasteve të përcak-tuara në aneksin 9);

e) mbledhja e të gjitha depozitave të depozi-tuesit si një llogari depozitë e vetme;

ë) krahasimi i vlerës së depozitës të vetme me 2 000 000 (dy milionë) lekë.

Neni 12

Kompensimi i depozitave

1. Agjencia kompenson depozitat e siguruara vetëm pas njoftimit me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës se ai ka ndërhyrë në SHKK.

2. SHKK-ja, për qëllim të kompensimit të depozitave, administron të dhënat për depozitat e individëve, tregtarëve dhe shoqërive tregtare të dokumentuara, si vijon:

a) kontrata e depozitës;

b) libreza e kursimit;

c) kartela e depozitës;

ç) dokumentet kontabël;

d) të dhënat e regjistrit elektronik.

3. Me qëllim zbatimin e nenit 26, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar, SHKK-të krijojnë, mirëmbajnë dhe garantojnë funksionimin e mirë të sistemeve elektronike, të cilat shërbejnë për mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave për vlerësimin e shumës së kompensimit në çdo kohë, sipas aneksit 10 "Vlerësimi i shumës së kompensimit", të këtij udhëzimi.

4. Shuma e kompensimit është vlera monetare që Agjencia kompenson, sipas kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore.

5. Për llogaritjen e shumës së kompensimit zbatohen kërkesat e mëposhtme:

a) mbajtja e saktë e të dhënave personale të depozituesit dhe të depozitave të këtij depozituesi;

b) mbajtja e një numri të vetëm (kodit personal në sistem) të depozituesit, me qëllim që ai të identifikohet në mënyrë të saktë dhe pa përsëritje;

c) zbatimin e përjashtimeve nga skema e sigurimit të depozitave;

ç) përllogaritjen e interesit ditor për çdo depozitë të depozituesit;

d) konvertimin në lekë të depozitave në valutë, sipas kursit zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës;

dh) zbatimin e kushteve kontraktore që zbato-hen ndaj çdo depozite (sipas rasteve të përcaktuara në aneksin 10);

e) mbledhja e të gjitha depozitave të depozi-tuesit si një llogari depozitë e vetme;

ë) krahasimi i vlerës së depozitës të vetme me 2 000 000 (dy milionë) lekë;

f) zbritja e shumës së kësteve të papaguara në afat që burojnë nga marrëdhënia kreditore e depozituesit me SHKK-në.

Neni 13

Kontributi fillestar

1. Çdo SHKK paguan në llogarinë e Agjencisë pranë Autoritetit Mbikëqyrës kontributin fillestar në masën 0,5 % të kapitalit në momentin e pagesës së tij.

2. SHKK-të, në fund të vitit të parë të anëtarësimit në skemë, paguajnë në llogarinë e Agjencisë pranë Autoritetit Mbikëqyrës shtesën e kontributit fillestar, që përllogaritet në masën 0,5 % të kapitalit të krijuar gjatë këtyre 12 muajve.

Neni 14

Primi i vitit të parë të aktivitetit

1. Primi i vitit të parë të aktivitetit për SHKK-në anëtare të skemës, vlerësohet me 0,3% të mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara të mbajtura në SHKK-në çdo ditë pune të kësaj periudhe, sipas aneksit 11 "Mënyra e përllogaritjes së primit të vitit të parë të aktivitetit" të këtij udhëzimi. Agjencia vlerëson në vend depozitat e siguruara në subjekt, duke verifikuar plotësimin e kushteve për përllogaritjen e primit, si dhe lëshon një raport verifikimi për këtë qëllim.

2. Për periudhën e mbetur nga mbarimi i vitit të parë të aktivitetit deri në fund të vitit kalendarik, primi tremujor vijues vlerësohet proporcionalisht dhe paguhet në përputhje me aneksin 12 "Përllogaritja e primit të parë tremujor pas vitit të parë të aktivitetit" të këtij udhëzimi.

Neni 15

Primi tremujor

1. Çdo SHKK i paguan Agjencisë primet e sigurimit.

2. Agjencia, me pagimin e primit dhe marrjen e deklaratës për primin nga SHKK-ja, i lëshon kësaj SHKK-je një vërtetim lidhur me arkëtimin e primit.

3. Primi tremujor i sigurimit është 0,075% e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara, që janë të regjistruara në SHKK në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm.

4. Pagesa e primit bëhet në lekë në llogarinë e Agjencisë në Autoritetin Mbikëqyrës, jo më vonë se data 15 e muajit të parë të tremujorit për të cilin paguhet.

5. Njëkohësisht me pagimin e primit për çdo tremujor çdo SHKK i paraqet Agjencisë deklaratën e llogaritjes së primit sipas aneksit 13 "Deklarata e primit tremujor" të këtij udhëzimi.

6. Në rast se për një tremujor, shuma e primit që është llogaritur nga sistemi i SHKK-së nuk përputhet me shumën e primit të vlerësuar nga sistemi i Agjencisë, SHKK-ja paguan paraprakisht primin e vlerësuar nga vetë ajo. Për të evidentuar arsyet e diferencave, Agjencia kryen verifikim në vend, dhe këto diferenca korrigjohen në pagesën e primit tremujor pasardhës. SHKK-ja paraqet në deklaratën e primit të tremujorit pasardhës vlerën e pagesës së korrigjimit të primit të mëparshëm sipas udhëzimeve të Agjencisë.

7. SHKK-ja, në fillim të tremujorit të katërt, por jo më vonë se data 5 dhjetor, dërgon në Agjenci parashikimin e primit që do t'i paguajë asaj për vitin e ardhshëm.

8. Në rastin kur parashikohet deficiti i fondit të sigurimit të depozitave për SHKK-të, Autoriteti Mbikëqyrës, me propozim të Këshillit Drejtues, mund të vendosë arkëtimin e primit tremujor para afatit nga çdo SHKK, në një vlerë jo më të madhe se katër herë primin e fundit të paguar.

9. SHKK-ja nuk do të paguajë primin/et e pagueshëm/me për periudhën pasardhëse, për aq kohë, sa shuma e tyre është më e vogël ose e barabartë me shumën e primeve të arkëtuara para afatit. Në çdo tremujor, Agjencia njofton SHKK-të lidhur me korrigjimet përkatëse për pagesën e primit pasardhës.

Neni 16

Primi shtesë

1. Autoriteti Mbikëqyrës njofton Agjencinë kur konstaton shkeljen e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit ose raportit midis kredive "standarde" dhe totalit të portofolit të kredive, të përcaktuara në aktet nënligjore të Autoritetit Mbikëqyrës. Në çdo rast, kur Agjencia konstaton shkeljen e këtyre treguesve njofton Autoritetin Mbikëqyrës dhe pas konfirmimit të këtij të fundit për shkeljen e këtyre treguesve nga ana e SHKK-së, Agjencia urdhëron SHKK-në të paguajë primin shtesë.

2. SHKK-ja paguan prim shtesë sa herë shkel treguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. Mënyra e përllogaritjes së primit shtesë përcaktohet në aneksin 16 të këtij udhëzimi.

3. SHKK-ja raporton çdo muaj në Agjenci respektimin e treguesve rregullatorë të vendosur nga Autoriteti Mbikëqyrës, brenda datës 15 të muajit pasardhës, sipas aneksit 15 të këtij udhëzimi.

4. Së bashku me raportimet sipas pikës 3 të këtij neni, SHKK-ja sjell në Agjenci, deklaratën e primit shtesë sipas aneksit 16, në rast se të paktën njëri nga dy treguesit më lart është shkelur.

5. Këshilli Drejtues i Agjencisë vendos për afatin e pagesës së primit shtesë nga SHKK-ja, i cili mund të paguhet me këste.

6. SHKK-ja paraqet pranë Agjencisë, nëpërmjet postës elektronike, dokumentin e kryerjes së pagesës të primit shtesë jo më vonë se dita e nesërme e punës nga kryerja e pagesës.

KREU IV
SHKËMBIMI I INFORMACIONIT, INFORMIMI I PUBLIKUT

Neni 17
Shkëmbimi i informacionit ndërmjet Agjencisë dhe SHKK-ve

1. SHKK-të kanë detyrimin ligjor të informojnë Agjencinë në vazhdimësi mbi veprimtarinë e mbledhjes së depozitave prej tyre, mbi përmbu-shjen e kushteve sipas ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar dhe këtij udhëzimi, si dhe mbi gjendjen e tyre financiare.

2. Agjencia informon SHKK-të si vijon:

a) mbi miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar;

b) për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore;

c) mbi materialet për trajnimin e personelit të SHKK-ve.

3. SHKK-të informojnë Agjencinë për të gjitha masat e marra në zbatim të rekomandimeve të saj.

4. SHKK-të dërgojnë në Agjenci pjesën e informacionit të sistemit raportues të unifikuar, në përputhje me rregulloret e Autoritetit Mbikëqyrës.

5. SHKK-të informojnë Agjencinë menjëherë për të gjitha masat administrative të marra nga Autoriteti Mbikëqyrës dhe institucione të tjera publike në zbatim të ligjeve në fuqi.

6. SHKK-të bashkëpunojnë me subjektet e autorizuara nga Agjencia ose me atë vetë, për qëllime anketimi dhe studimi për informimin e publikut dhe përmirësimin e kërkesave ligjore për sigurimin dhe kompensimin e depozitave.

7. SHKK-të dërgojnë në Agjenci të dhënat sipas aneksit 14 "Klasifikimi i depozitave" të këtij udhëzimi, në mënyrë elektronike brenda datës 10 të muajit pasardhës.

8. SHKK-të dërgojnë në Agjenci të dhënat sipas aneksit 17 "Formulari i raportimit tremujor" të këtij udhëzimi, jo më vonë se 15 ditë pune pas përfundimit të çdo tremujori.

9. SHKK-të dërgojnë në Agjenci raportin mujor të përputhshmërisë, të gjendjes së depozitave në bilancin e përgjithshëm, me depozitat e paraqitura në skedarin e dërguar në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim të Agjencisë, sipas aneksit 18 të këtij udhëzimi. Raporti përmban të dhëna të detajuara mbi zërat e përfshirë në llogaritjen e depozitave të individëve, tregtarëve dhe shoqërive tregtare. Ky raport dërgohet në Agjenci brenda datës 15 të muajit pasardhës.

10. Të dhënat mbi depozitat dhe depozituesit që SHKK-të raportojnë në Agjenci në zbatim të këtij udhëzimi, duhet të përputhen me njëra-tjetrën. Këto të dhëna duhet të përfshijnë në çdo rast të gjithë depozituesit aktivë të SHKK-ve, si dhe ata depozitues që nuk kanë kryer veprime me depozitat e tyre për një periudhë të caktuar, por balanca e të cilave është më e madhe se zero. SHKK-të raportojnë në mënyrë elektronike mbi cilësinë e të dhënave të depozituesve çdo tremujor, brenda datës 10 të muajit pasardhës për këtë tremujor. Formati i raportimit përcaktohet nga Agjencia.

11. SHKK-ja dërgon në Agjenci të dhënat për personin përgjegjës dhe/ose të kontaktit për çështjet e sigurimit dhe kompensimit të depozitave. Të dhënat përfshijnë emrin dhe mbiemrin e personit përkatës, funksionin e tij, postën elektronike dhe numrin e telefonit. Personat përgjegjës dhe/ose të kontaktit për çështje të sigurimit dhe kompensimit të depozitave caktohen në përputhje me aktet e brendshme normative të subjektit për zbatimin e kushteve sipas këtij udhëzimi. Agjencia njoftohet menjëherë për çdo ndryshim në këtë listë.

12. SHKK-të dorëzojnë në Agjenci, statutin e subjektit dhe rregulloret e funksionimit të tyre, si dhe aktet për administrimin e depozitave dhe, në veçanti, për:

a) përbërjen e Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit Drejtues, të Komitetit të Kontrollit, aktet e emërimit

të administratorit dhe komitetit të huas (nëse ka) të SHKK-së;

b) shtrirjen gjeografike të SHKK-së dhe të degëve (nëse ka);

c) riorganizimin e strukturave;

ç) ndryshimin e selisë dhe/ose vendit /adresave dytësore të ushtrimit të aktivitetit;

Agjencia njoftohet, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e vendimit të organit përkatës, për çdo ndryshim në këto akte.

13. SHKK-të dorëzojnë në Agjenci pasqyrat financiare dhe raportin e kontrollit të brendshëm, njëkohësisht me dorëzimin e tyre në Autoritetin Mbikëqyrës.

14. SHKK-të të cilat janë anëtare të një Unioni, dorëzojnë në Agjenci përmbledhje të monitorimit të kryer nga Unioni, si dhe rekomandimet dhe masat e marra ndaj tyre, jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga data që janë informuar për to.

15. SHKK-të mbajnë përgjegjësi ligjore për vërtetësinë, saktësinë dhe plotësinë e informacionit dhe dokumentacionit të dërguar në Agjenci, sipas këtij udhëzimi.

16. Në qoftë se datat e raportimit përkojnë me ditët e pushimit zyrtar, ai kryhet në ditën vijuese të punës.

17. Agjencia mund të sigurohet për saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit të dhënë në-përmjet verifikimeve të kryera drejtpërsëdrejti në SHKK.

Neni 18

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet Agjencisë dhe Autoritetit Mbikëqyrës

1. Agjencia kërkon të dhëna për SHKK-të anëtare të skemës nga Autoriteti Mbikëqyrës, në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar, që kanë të bëjnë me:

a) bilancin kontabël të raportuar nga SHKK-të;

b) pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të raportuar nga SHKK-të;

c) normat mbikëqyrëse të raportuara nga SHKK-të dhe informacioni cilësor mbështetës.

ç) masat mbikëqyrëse, sanksionet dhe gjobat të vendosura ndaj SHKK-ve.

2. Agjencia informon Autoritetin Mbikëqyrës, me kërkesë të tij, në lidhje me depozitat e siguruara në SHKK-të anëtare të skemës.

Neni 19

Informimi i publikut

1. Agjencia kryen informimin e publikut mbi skemën e sigurimit të depozitave drejtpërdrejt, si dhe nëpërmjet SHKK-ve.

2. Agjencia bashkëpunon me SHKK-të për të përcaktuar përmbajtjen e informacionit që përcillet dhe fushatat e informimit të publikut.

3. SHKK-të informojnë depozituesit dhe të tretët mbi sigurimin dhe kompensimin e depo-zitave, në përputhje me aneksin 8, formulari 1 "Mënyrat kryesore për informimin e publikut" të këtij udhëzimi.

4. SHKK-të tërheqin nga Agjencia materiale për informimin e publikut të përgatitura prej saj brenda afatit të përcaktuar në njoftimin e dërguar. SHKK-të vendosin materialet e informimit të publikut në një vend të dukshëm në mjediset me të cilat veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe i publikojnë ato në faqen e internetit të SHKK-së.

5. Faqja e internetit të SHKK-së duhet të sigurojë linkun ndërlidhës me faqen e internetit të Agjencisë.

6. SHKK-të përfshijnë në kontratën e depozitës që nënshkruhet nga depozituesi një aneks të veçantë për informimin mbi sigurimin e depozitës, i cili i bashkëlidhet kontratës, sipas modelit të përcaktuar në aneksin 8, formulari 2 të këtij udhëzimi.

7. SHKK-të duhet të shtojnë në pasqyrat dhe fletëpalosjet për depozitat, një shënim në lidhje me sigurimin e depozitës nga Agjencia. Formulimi i këtij shënimi përcaktohet në aneksin 8, formulari 3 të këtij udhëzimi.

8. SHKK-të vendosin certifikatën për sigurimin e depozitave në një vend të dukshëm në mjediset me të cilat veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

9. Agjencia siguron trajnime për SHKK-të për çështje të sigurimit të depozitave.

10. SHKK-të sigurojnë trajnime për punonjësit e tyre që punojnë me klientët në lidhje me sigurimin e depozitave.

KREU V
PËRMBAJTJA, INFORMACIONI DHE FUNKSIONIMI I SISTEMIT INFORMATIK PËR RAPORTIM DHE KOMPENSIM

Neni 20
Qëllimi i marrjes dhe përpunimit të informacionit

1. Agjencia zotëron sistemin e saj informatik, me qëllim trajtimin e qendërzuar dhe shpërndarjen e informacionit të raportuar në të nga SHKK-të anëtare të skemës, në funksion të sigurimit dhe kompensimit të depozitave, të verifikimit të SHKK-ve, dhe të administrimit optimal të rrezikut të sigurimit të depozitave nga SHKK-të anëtare.

2. Autoriteti përgjegjës për administrimin e sistemit informatik për raportim dhe kompensim është Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

Neni 21
Parimet e funksionimit të sistemit informatik për raportim dhe kompensim

1. Parimi bazë i funksionimit të sistemit është përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave/ informa-cionit të tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të dhënat personale dhe të sekretit profesional.

2. Sistemi funksionon për trajtimin e centra-lizuar dhe shpërndarjen e informacionit që mbahet dhe përpunohet në të.

3. Të drejtat për njohjen dhe përpunimin e informacionit në sistem do të jenë të certifikuara, të autorizuara dhe të regjistruara.

4. Agjencia nuk mban përgjegjësi për mënyrën e përdorimit dhe vlerësimit të informacionit dhe dokumenteve që shpërndan sistemi në rastet kur këto të fundit janë të pasakta ose të paplota si rrjedhojë e raportimit të pasaktë, të paplotë ose për gabime në përpunimin e informacionit nga përdo-ruesit e saj të autorizuar.

Neni 22
Funksionet e sistemit informatik për raportim dhe kompensim

Sistemi informatik i Agjencisë dhe raportimi i të dhënave në të nga SHKK-të funksionon në mënyrë të tillë, që të sigurojë:

a) Gatishmërinë e të dhënave në çdo kohë për identifikimin e depozituesit në mënyrë unike në sistem nëpërmjet të dhënave personale të një depozituesi konkret, ku përcaktohet saktë shuma që SHKK-ja i detyrohet këtij depozituesi, të cilën edhe e siguron pranë Agjencisë;

b) Përqendrimin e informacionit lidhur me depozitat dhe depozituesit, mbi baza individuale dhe/ose të agreguara;

c) Vlerësimin e saktësisë së të dhënave perso-nale të depozituesve në regjistrat elektronikë të subjekteve;

ç) Vlerësimin e saktësisë së përllogaritjes së shu-mës së siguruar;

d) Vlerësimin e saktësisë së përllogaritjes së primit periodik;

dh) Mundësinë e qasjes së menjëhershme te të dhënat mbi depozitat dhe depozituesit për të kryer vlerësimin e saktë të shumës së kompensimit në rast simulimi ose ngjarjeje sigurimi;

e) Përmbushja e kushteve dhe parametrave të raportimit edhe nga palët e treta të cilat u ofrojnë shërbime SHKK-ve për përmbushjen e kërkesave të këtij udhëzimi dhe në zbatim të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depo-zitave", i ndryshuar;

ë) Përdorimin dhe/ose publikimin e informa-cionit nga Agjencia në përputhje me nenin 35 të këtij udhëzimi.

Neni 23
Përmbajtja e informacionit/të dhënave të Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim

1. Në përputhje me rregullat dhe mënyrën e përcaktuar në këtë udhëzim, në sistemin informatik për raportim dhe kompensim raportohen, mbahen dhe përpunohen të dhëna/informacion në lidhje me identifikimin e saktë të depozituesve dhe informacion analitik mbi gjendjen e depozitave.

2. Informacioni i cili raportohet, mbahet dhe përpunohet në sistemin informatik për raportim dhe kompensim, përcaktohet në përputhje me informacionin e regjistrit elektronik të detyrimeve depozitë të administruar nga SHKK-të anëtare të skemës.

3. Informacioni i raportuar për depozitat dhe depozituesit duhet të qartësojë diferencimin midis

depozitave të sigurueshme dhe të pasigurueshme.

4. Sistemi informatik për raportim dhe kompensim nuk mban apo trajton të dhëna personale sensitive, me të cilat do të kuptohen të dhëna të tilla si:

a) origjina racore dhe etnike, bindjet dhe përkatësitë politike, bindjet fetare dhe të tjera;

b) gjendja shëndetësore, jeta seksuale dhe gjendja penale.

Neni 24

E drejta për të njohur, përpunuar dhe përdorur informacionin e Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim

1. Të drejtën për të njohur, përpunuar dhe përdorur informacionin që raportohet dhe trajtohet në sistemin informatik e ka Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Kjo e drejtë ushtrohet në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi dhe aktet e tjera nënligjore për sigurimin e depozitave.

2. SHKK-të kanë të drejtë të njihen me të dhënat historike të raportuara nga vetë ato, si dhe me vlerat e primit të përllogaritur nga Agjencia, për aq kohë sa ato ruhen në sistem.

3. Likuidatori ka të drejtë të njihet me ecurinë e procesit të kompensimit dhe pagesat e depozitave, sipas të dhënave në Sistemin Informatik.

Neni 25

Raportimi i të dhënave në Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim

1. SHKK-të raportojnë në Sistemin Informatik të dhënat e përcaktuara sipas nenit 23 të këtij udhëzimi dhe në përputhje me formatin standard të skedarëve të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë.

2. SHKK-të kanë përgjegjësinë të korrigjojnë të dhënat derisa ato të pranohen nga sistemi informatik.

3. SHKK-të kanë të drejtë t'i mbishkruajnë ato brenda afateve të lejuara.

4. Autetinciteti i të dhënave në sistemin informatik dhe pandryshueshmëria e tyre mund të vlerësohen nëpërmjet kodit HASH të gjeneruar menjëherë pas raportimit të suksesshëm.

5. Agjencia ka të drejtë të kërkojë raportim nga SHKK-të në çdo moment për qëllime të veçanta dhe të paparashikuara për përmbushjen e objektivave publikë të veprimtarisë së saj.

6. SHKK-të, para se të përpunojnë apo të raportojnë informacionin dhe të dhënat e përcaktuara në këtë udhëzim për qëllime të sistemit informatik, duhet të autorizohen paraprakisht me shkrim nga depozituesit, nëpërmjet përfshirjes së këtij autorizimi në kontratën e depozitës dhe/ose dosjen e tij pranë SHKK-së sipas aneksit 5 "Klauzola e pëlqimit paraprak si pjesë e kontratës së depozitës" të këtij udhëzimi.

7. Moduli i ngarkimit do t'u japë përdoruesve të SHKK-së mundësinë të ngarkojnë skedarë për periudha dhe qëllime specifike.

8. Për qëllim të përllogaritjes të shumës së sigurimit SHKK-të ngarkojnë, çdo muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës, skedarët sipas formatit standard të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues me të dhëna mbi:

a) depozitat – të dhënat e llogarive të lidhura me depozitat individuale në SHKK;

b) depozituesit – të dhënat e detajuara të depozituesit individ, tregtar dhe shoqëri tregtare që e identifikojnë saktësisht atë.

9. Për çdo tremujor brenda datës 10 të muajit pasardhës të tij, SHKK-të raportojnë në Agjenci primin e përllogaritur për çdo depozitues dhe ngarkojnë skedarin e primit sipas formatit standard të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues.

10. Në rast procesi kompensimi ose simulimi, SHKK-së do t'i kërkohet të ngarkojë skedarë ditorë sipas: formatit standard të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues me të dhëna mbi:

a) depozitat – të dhënat e llogarive të lidhura me çdo depozitë individuale në SHKK;

b) depozituesit – të dhënat e detajuara të depozituesve individë, tregtarë dhe shoqëri tregtare që i identifikojnë ata saktësisht;

c) kreditë – kreditë e detajuara të lidhura me depozitat që janë vënë si garanci për këto kredi;

ç) pozicioni i netuar i depozituesve-depozituesit në pozicionin e netimit.

11. Çdo skedar të dhënash përbëhet nga krye rreshti që i përket kontrollit të të dhënave, dhe të dhënat e rreshtave që i përkasin formatit të skedarit. Fushat janë të ndara me karakterin '|' dhe skedarët kërkohen në format tekst (txt) ose ekuivalente me të.

12. Me kërkesë të Agjencisë, skedarët mund të ngarkohen edhe për qëllime të veçanta dhe të paparashikuara me qëllim zbatimin e objektivave publikë të veprimtarisë së saj, sipas afateve të përcaktuara nga Agjencia.

Neni 26

Përgjegjësia për saktësinë e informacionit dhe të dhënave

1. SHKK-të janë përgjegjëse për saktësinë dhe plotësinë e informacionit dhe të të dhënave të raportuara në bazë të këtij udhëzimi, dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për këtë qëllim.

2. Drejtuesit e njësive të SHKK-ve që përgatitin dhe monitorojnë informacionin dhe të dhënat e dërguara pranë Agjencisë sipas formatit standard të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues, i certifikojnë ato çdo muaj nëpërmjet nënshkrimit të formularit të përcaktuar në aneksin 7 "Deklarata e përputhshmërisë" të këtij udhëzimi.

3. Certifikata mujore e përputhshmërisë që shoqëron raportimin sipas pikës 2 të këtij neni, paraqitet në Agjenci brenda datës 15 të çdo muaji.

4. Nëse SHKK-të konstatojnë se ndonjë prej informacioneve ose të dhënave të raportuara janë të pasakta ose të paplota, njoftojnë menjëherë Agjencinë duke kryer njëkohësisht korrigjimin e informacioneve/të dhënave të pasakta ose të paplota, dhe duke i raportuar ato përsëri në sistemin informatik.

5. Nëse Agjencia vëren se informacioni/të dhënat e raportuara apo të mbajtura në sistemin informatik janë të pasakta apo të paplota, njofton SHKK-në për këtë. Me marrjen e njoftimit, SHKK-ja duhet të shpjegojë arsyen e pasaktësisë apo të paplotësisë dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për korrigjimin e menjëhershëm të tyre.

6. Agjencia ka të drejtë të pezullojë aksesin e SHKK-së në sistemin informativ nëse kjo e fundit nuk merr masat e nevojshme apo nuk zbaton kërkesën e Agjencisë për rishikimin apo korrigjimin e të dhënave të pasakta apo të paplota.

Neni 27

Përdoruesit e autorizuar të informacionit dhe të të dhënave

Përdoruesit e autorizuar të informacionit dhe të të dhënave që mbahen në sistemin informatik, janë:

a) punonjësit e miratuar të SHKK-së;

b) punonjësit e miratuar të Agjencisë.

Neni 28

Miratimi i përdoruesve të autorizuar të SHKK-ve

1. Agjencia miraton përdoruesit e autorizuar të SHKK-së, të parashikuar në nenin 27 shkronja "a" të këtij udhëzimi.

2. SHKK-ja dërgon për miratim pranë Agjen-cisë kërkesën për miratimin e përdoruesit të autorizuar. Kërkesës i bashkëlidhet formulari i plotësuar sipas aneksit 6 të këtij udhëzimi, duke parashtruar dhe arsyet përkatëse.

3. Kërkesa për miratim mund të refuzohet në rast se gjykohet se ky refuzim i shërben ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit/të dhënave që përmban sistemi informatik. Ky refuzim nuk mund të cenojë mbarëvajtjen dhe funksionimin e rregullt të sistemit informatik.

Neni 29

Kushtet e marrjes së informacionit dhe të dhënave nga sistemi informatik

1. Informacioni dhe të dhënat e mbajtura në sistemin informatik përbëjnë sekret profesional dhe duhen trajtuar dhe ruajtur si të tilla nga të gjithë përdoruesit e autorizuar të tij.

2. SHKK-të, për të dhënat që raportojnë në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi, nuk do të konsiderohen se kanë shkelur detyrimin për ruajtjen e sekretit profesional.

3. Përdoruesit e autorizuar dhe/ose SHKK-të janë përgjegjës për shkeljen e detyrimit të ruajtjes së sekretit profesional, kur e përpunojnë informa-cionin dhe të dhënat e përfituara nga sistemi elektronik në kundërshtim ose jashtë qëllimeve të këtij udhëzimi.

Neni 30

Kohëzgjatja e mbajtjes së informacionit dhe e të dhënave në sistemin informatik

1. Agjencia mban në sistemin informatik informacionin dhe të dhënat e raportuara, për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh nga data në të cilën depozita është raportuar si depozitë e siguruar sipas formatit të raportimit të të dhënave në sistemin informatik.

2. Në rast të ngjarjes së sigurimit, Agjencia mban në sistemin informatik, informacionin dhe të dhënat e

raportuara për depozitat për një periudhë prej 10 (dhjetë) vjetësh nga data e ngjarjes së sigurimit. Të dhënat dhe informacioni ruhen sipas formatit të raportimit të të dhënave në sistemin informatik.

3. Pas përfundimit të afateve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, informacioni dhe të dhënat fshihen nga sistemi informatik.

Neni 31

Detyrimet e SHKK-ve për mbajtjen e regjistrit të tyre elektronik

1. SHKK-të ruajnë të saktë dhe në kohë reale informacionin për depozitat dhe depozituesit në sistemet e tyre elektronike në përputhje dhe për zbatim të nenit 26 "Regjistri elektronik i detyrimeve depozitë të subjektit", të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndry-shuar, në përputhje me anekset 3 dhe 4 të këtij udhëzimi, si dhe me formatin standard të skedarëve të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë.

2. SHKK-të mundësojnë gatishmërinë e prodhimit të skedarëve në çdo kohë dhe sipas kërkesës së Agjencisë, Autoritetit Mbikëqyrës dhe Likuidatorit në përputhje me aneksin 4 të këtij udhëzimi.

3. SHKK-të raportojnë në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

4. SHKK-të marrin masa për raportim shkresor dhe elektronik brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim në rast se regjistri i tyre elektronik dhe/ose sistemi informatik janë përkohësisht jashtë shërbimit.

5. SHKK-të, nëpërmjet akteve të brendshme rregullojnë procedurat për marrjen dhe raportimin e informacionit/të dhënave për depozituesit e tyre, për korrigjimin e informacionit/të dhënave të pasakta ose të paplota, për mbrojtjen e konfiden-cialitetit të këtij informacioni, si dhe çdo procedurë tjetër të nevojshme lidhur me përfshirjen e tyre në sistemin informatik dhe zbatimin e akteve nën-ligjore përkatëse.

6. SHKK-të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e informacionit/të dhënave që raportojnë në regjistrin e detyrimeve depozitë dhe sistemin informatik të Agjencisë nga dëmtimet apo përdorimet e paautorizuara.

Neni 32

Testimi i procedurave të "*Fallback Recovery*" në sistemin informatik

1. Agjencia kryen në mënyrë periodike testimin e procedurave të saj të "*Fallback Recovery*" për ngjarjet e paparashikuara në bashkëpunim dhe me SHKK-në raportuese të sistemit informatik.

2. Agjencia njofton SHKK-të për kalimin e të dhënave të sistemit informatik primar në sistemin informatik *backup*, për zhvillimin e testimit të procedurave të "*Fallback Recovery*", si dhe për çdo veprim që ata duhet të ndërmarrin, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune para datës së testimit.

Neni 33

Procedurat operacionale dhe administrimi i brendshëm i sistemit informatik

Agjencia nxjerr aktet e nevojshme, ndërmjet të tjerash, në lidhje me:

a) funksionet, përgjegjësitë dhe procedurat e brendshme operacionale për administrimin e sistemit informatik;

b) procedurat për nxjerrjen e raportit për depozituesin dhe rishikimin e të dhënave që mbahen në sistemet e SHKK-ve dhe sistemin e Agjencisë.

Neni 34

Përgjegjësia në rastin e forcave madhore

1. SHKK-të që raportojnë në sistem nuk mbajnë përgjegjësi për mospërmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, që vijnë si pasojë e gjendjes së jashtëzakonshme, të luftërave, të demonstratave, turbullirave të tjera civile, fatkeqësive natyrore dhe për çdo rrethanë tjetër jashtë kontrollit të tyre, si dhe si pasojë e çdo force tjetër madhore.

2. SHKK-të që nuk janë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre për shkaqet e përcaktuara në pikën 1, duhet:

a) të njoftojnë Agjencinë me shkrim mbi shkakun dhe shkallën që i ka penguar në përmbushjen e detyrimeve;

b) të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të rifilluar përmbushjen e detyrimeve sa më shpejt që të jetë e mundur dhe njëkohësisht, të përpiqen të minimizojnë efektet negative të shkaqeve të përcaktuara në pikën 1.

Neni 35
Publikimet

Agjencia mund të përpunojë dhe publikojë informacionin dhe të dhënat e mbajtura në sistemin informatik për qëllime kërkimore, statistikore dhe në shërbim të procesit të sigurimit dhe kompensimit të depozitave, mbi baza të konsoli-duara dhe duke garantuar anonimatin e tyre, pa veçuar SHKK-të ose depozitues të caktuar.

KREU VI
VERIFIKIMI, MASAT PARANDALUESE DHE SANKSIONET

Neni 36
Verifikimi i SHKK-ve

1. Agjencia sigurohet për saktësinë dhe vërtetësinë e informacionit dhe dokumentacioneve, të paktën një herë në vit, edhe nëpërmjet procesit të verifikimit të kryer drejtpërsëdrejti në SHKK.

2. Agjencia sipas rastit kërkon nga Autoriteti Mbikëqyrës përfshirjen e përfaqësuesve të saj në ekzaminimet që Autoriteti Mbikëqyrës kryen në SHKK-të.

3. Agjencia verifikon SHKK-të nëpërmjet Grupit të Verifikimit, i cili përbëhet nga punonjës të Agjencisë, sipas çështjeve konkrete të verifikimit.

4. Programi i punës përbën dokumentin për fillimin dhe zbatimin e procedurave të verifikimit.

5. Rubrikat kryesore të programit të punës, janë:

a) objekti;

b) qëllimi;

c) data e fillimit të verifikimit;

ç) data e përfundimit të verifikimit;

d) periudha për t'u verifikuar;

dh) personat pjesëmarrës të Grupit të Verifikimit;

e) baza ligjore;

ë) problematika dhe materialet e kërkuara për verifikim.

6. Personat pjesëmarrës të Grupit të Verifikimit kanë të drejtë t'i kërkojnë personave përgjegjës të SHKK-ve që të paraqesin:

a) një informacion të veçantë ose informacion për çështje të veçanta, që kanë lidhje me sigurimin dhe kompensimin e depozitave;

b) një dokument të veçantë ose dokumente për çështje të veçanta, që kanë lidhje me sigurimin dhe kompensimin e depozitave.

7. Informacioni ose dokumentet duhet të dorëzohen ose të përpilohen:

a) përpara përfundimit të afatit të arsyeshëm në të cilin kërkohen;

b) në vendin në të cilin kërkohen.

8. SHKK-të mbajnë përgjegjësi ligjore për vërtetësinë, saktësinë dhe plotësinë e informacionit të paraqitur Grupit të Verifikimit të Agjencisë.

Neni 37
Objekti i verifikimit

1. Drejtimet kryesore të procesit të verifikimit janë, por pa u kufizuar:

a) verifikimi i mbajtjes së të dhënave të depozitave dhe depozituesve, duke evidentuar në veçanti:

- zbatimin e procesit të dokumentimit të depozitave në përputhje me krerët III dhe V të këtij udhëzimi;

- saktësinë e mbajtjes së të dhënave për depozitat një emërore dhe dy emërore dhe të kalimit të një depozite nga një emërore në dy emërore dhe anasjellas;

- saktësinë e mbajtjes së të dhënave të kontratës së depozitës, librezës së kursimit, kartelës së depozitës, dokumenteve kontabël dhe dokumen-teve të arkës;

- informimin mbi kallëzimet penale të bëra dhe procesverbalet e mbajtura nga subjekti kundër mbajtësit të depozitës dhe/ose përfaqësuesit të tij në rastet kur janë konstatuar regjistrime të falsifikuara në dokumentacionin e depozitës;

- informimin mbi rastet e zëvendësimit/ humbjes të kontratës së depozitës dhe librezës së kursimit (lëshimi i dublikatave);

- informimin mbi veprimet me depozitat me dëshmi trashëgimie dhe prokurë;

- informimin mbi hapjen, veprimet dhe mbylljen e depozitave të kursimit të kushtëzuara dhe depozitat e garancisë;

b) vlerësimi i metodologjisë dhe saktësisë së përllogaritjes së shumës së depozitës së siguruar, të shumës së kompensimit dhe llogaritjes të primeve të sigurimit, duke krijuar një bazë të dhënash mbi ecurinë e hapave të përdorura në funksion të transparencës së procesit, dhe dokumentimin e këtij në një manual teknik përdorimi;

c) verifikimi i përputhshmërisë së kuadrit nënligjor të subjekteve me dispozitat e ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar, në veçanti manualet teknike të proceseve të punës me përshkrimin e hapave për zbatimin e detyrimeve;

ç) verifikimi i mënyrës së informimit të publikut në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar;

d) verifikimi i raporteve të strukturave përkatëse të SHKK-së për auditimin e zbatimit të kërkesave ligjore dhe akteve të subjektit për çështje të sigurimit dhe kompensimit të depozitave, si dhe për administrimin e depozitave.

Neni 38

Masat parandaluese

1. Grupi i verifikimit në përfundim të procesit të verifikimit, në një takim të posaçëm informon personat përgjegjës në SHKK, lidhur me gjetjet nga procesi i verifikimit, shkeljet e mundshme nëse ka, kohën e nevojshme që i duhet subjektit për të hartuar planin e masave dhe/ose veprimeve rregulluese, si dhe përfundimet paraprake.

2. Raporti i verifikimit, përmban një përshkrim të detajuar të ecurisë së procedurave të verifikimit, të veprimeve dhe/ose masave rregulluese, si dhe udhëzimeve orientuese. Raporti i verifikimit miratohet nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë.

3. Në rast se shkeljet e konstatuara në raportin e verifikimit nuk korrigjohen brenda afatit të përcaktuar në të, drejtori i përgjithshëm i propozon Këshillit Drejtues miratimin e masave parandaluese sipas ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar.

4. Subjektet i paraqesin Agjencisë një raport të hollësishëm mbi masat e marra për eliminimin e shkeljeve sipas afatit të përcaktuar në vendimin e Këshillit Drejtues. Agjencia verifikon eliminimin e këtyre shkeljeve dhe merr një vendim mbi pranimin ose refuzimin e raportit sipas ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar.

5. Në rast refuzimi të raportit mbi eliminimin e shkeljeve, Këshilli Drejtues i propozon Autoritetit Mbikëqyrës marrjen e sanksioneve sipas ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, "Për shoqëritë e kursim- kreditit dhe unionet e tyre".

Neni 39

Sanksionet

1. Autoriteti Mbikëqyrës, në rast shkeljeje të dispozitave të këtij udhëzimi nga SHKK-të, me propozim të Agjencisë merr masat ndëshkimore të parashikuara në ligjin nr. 52/2016, datë 19.5.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre" dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

2. Do të konsiderohen shkelje të këtij udhëzimi, përveç atyre të parashikuara në ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar, veprimet e mëposhtme:

a) mosdërgimi i informacionit dhe i të dhënave brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim;

b) raportimi i informacionit ose i të dhënave që dihet se janë të pasakta ose të rreme;

c) përdorimi i paautorizuar ose keqpërdorimi i informacionit dhe i të dhënave;

ç) përdorimi i informacionit në kundërshtim me dispozitat e këtij udhëzimi;

d) shkelja e sekretit/konfidencialitetit dhe/ose zbulimi i paautorizuar i informacionit/të dhënave;

dh) mosrespektimi i detyrimeve të parashikuara në këtë udhëzim, në lidhje me korrigjimin e të dhënave të pasakta apo të paplota;

e) raportimin e të dhënave në kundërshtim me ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar dhe dispozitat e këtij udhëzimi.

3. Vendosja e sanksioneve nga Autoriteti Mbikëqyrës ndaj SHKK-ve nuk përjashton përgjegjësinë civile apo penale, të parashikuar në akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KREU VII

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 40

Përjashtimi i SHKK-ve nga skema

1. Agjencia e përjashton SHKK-në nga skema kur njoftohet me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për revokimin e licencës.

2. Agjencia njofton Autoritetin Mbikëqyrës për përjashtimin e SHKK-së nga skema, brenda 24 orëve nga vendimi i Këshillit Drejtues.

3. SHKK-ja, e cila njoftohet nga Agjencia për përjashtimin nga skema e sigurimit të depozitave sipas këtij neni, dorëzon menjëherë në Agjenci certifikatën e sigurimit të depozitave.

4. Në çdo rast, Agjencia kompenson depozitat vetëm pas njoftimit me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për ndërhyrjen në SHKK.

Neni 41

Dispozita kalimtare

1. SHKK-të e licencuara dhe që kanë paraqitur kërkesën për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) gjatë vitit të parë nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, të regjistrojnë të dhënat për depozitat dhe depozituesit në sistemet e tyre elektronike, jo më vonë se dita pasardhëse e punës nga momenti i kryerjes së veprimeve me depozituesin. SHKK-të anëtare të skemës, duhet të sigurohen që në përfundim të vitit të parë pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi dhe në çdo kohë, t'i regjistrojnë këto të dhëna në sistemet e tyre elektronike në kohë reale;

b) paguajnë kontribut fillestar në masën 0.5 % të kapitalit të raportuar në sistemin raportues të Autoritetit Mbikëqyrës, për fundin e shtatorit 2016, sipas njoftimit të Agjencisë. Pas pagesës së kontributit fillestar, më datë 30 nëntor 2016 me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë, SHKK-të do të marrin vërtetimin për përmbushjen e kushteve, si dhe certifikatën e sigurimit të depozitave. Certifikata e sigurimit të depozitave hyn në fuqi në datën 1 janar 2017. SHKK-të paguajnë diferencën në pagesën e kontributit fillestar, nëse ka shtesë në kapitalin e tyre për periudhën 30 shtator – 31 dhjetor 2016. Kjo pagesë bëhet sipas njoftimit të Agjencisë, pas certifikimit të bilancit të SHKK-ve;

c) raportojnë jo më vonë se data 10 nëntor 2016 në sistemin informatik për Raportim dhe Kompensim të dhënat për depozitat dhe depozituesit të datës 31 tetor 2016, në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi.

Neni 42

Dispozita përfundimtare

1. Anekset bashkëlidhur janë pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, shfuqizohet udhëzimi "Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit", të miratuar me urdhër të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë nr. 3242, datë 18.12.2014.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

GUVERNATOR

Gent Sejko

ANEKSI 1

Kërkesë për anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit _____, që kërkon të licencohet/të licencuar për të kryer veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

Me anë të kësaj kërkese i drejtohemi Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave në përputhje me ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar.

Shprehemi të gatshëm për të plotësuar çdo kërkesë të Agjencisë lidhur me kushtet e anëtarësimit në funksion të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bashkëlidhur do të gjeni dokumentacionin që vërteton plotësimin e kushteve për anëtarësimin në skemë, si dhe informacion për: kapitalin, anëtarët, Këshillin Drejtues, komitetin e mbikëqyrjes, komitetin e huas, administratorët (nëse ka), statutin, si dhe planin e veprimtarisë së subjektit.

Shënim. Plani i veprimtarisë si subjekt ndryshon nga plani i veprimeve për përmbushjen e kushteve për pranimin në skemën e sigurimit dhe kompensimit të depozitave.

Emri i shoqërisë së kursim-kreditit

_____

Adresa_____

Kërkuesit _____

Nënshkrimi i personit të kontaktit

Shënim. Kërkesa e shoqëruar me dokumentet dhe me formularët e kërkuar në mbështetje të këtij udhëzimi dërgohen në adresën e mëposhtme:

Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Rruga e Elbasanit
Pallati EDIL Al-IT, nr. 317, kodi postal 1010
Tiranë, Shqipëri.

Kryetari i Këshillit Drejtues të SHKK-së

(emër, mbiemër, firmë)

Data e kërkesës për licencë në BSH
Data e protokollimit të kërkesës në Agjenci

Formulari nr. 1 (vazhdim i aneksit nr. 1)

Vendimi i Këshillit Drejtues për caktimin e personit të kontaktit

Këshilli Drejtues i propozuar vërteton që informacioni i paraqitur në këtë kërkesë është i vërtetë dhe i plotë.

Këshilli Drejtues emëron dhe përcakton si person kontakti:

Emërohet si person kontakti:

_____

(emri) (atësia) (mbiemri)

Adresa:

_____

(rruga, numri) (qyteti)

_____ (numri i telefonit)

_____ (numri i faksit/teleksit)

_____ (adresa e postës elektronike)

Personi i kontaktit është i autorizuar të përfaqësojë SHKK-në dhe të paraqitet të nënshkruajë para Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, përveç rasteve kur kjo e fundit do të kërkojë veprime personale nga anëtarët e Këshillit Drejtues.

Personi i kontaktit i emëruar mund të ndryshohet me vendim të pranuar nga pjesa më e madhe e nënshkruesve, vendim i cili do të vërtetohet në Agjenci nga nënshkruesit që votojnë për të njëjtën gjë.

Datë _____

(emri mbiemri) i anëtarëve të këshillit (nënshkrimi)

_____ _____

_____ _____

_____ _____

_____ _____

_____ _____

Shënim. Ky formular vërtetohet nga noteri.

Formulari nr. 2 (vazhdim i aneksit nr. 1)

Totali i kapitalit të SHKK-së, sipas raportimit në Autoritetin Mbikëqyrës*

Nr.	**Përshkrimi**	**Data dhe nr. i vendimit të Asamblesë së Aksionarëve/ data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit/raportuar në Autoritet Mbikëqyrës**	**Shuma në lekë**

* SHKK-të ekzistuese para miratimit të këtij udhëzimi, e plotësojnë këtë formular në përputhje me nenin 41 të tij.

Formulari nr. 3 (vazhdim i aneksit nr. 1)

Numri i anëtarëve, masa e kontributit të anëtarësisë dhe donacione

Numri i anëtarëve	Kontributi i anëtarësisë në vlerë	Donacione dhe subjekti	Totali

Formulari nr. 4 (vazhdim i aneksit nr. 1)

Këshilli Drejtues, komiteti i kontrollit, auditues ligjor, komiteti i huas (nëse ka) dhe administratorët të SHKK-së, së bashku me CV-në e tyre.

Për SHKK-të

Nr.	Emri, mbiemri	Emërtimi i detyrës	Data e fillimit në detyrë

Formulari nr. 5 (vazhdim i aneksit nr. 1)

Rrjeti i degëve të SHKK-ve
Të paraqiten:
- dokumentet e pronësisë ose të qirasë për ambientet e zyrave;
- kontratat e sigurisë fizike.

(SHKK-të dhe degët, vendndodhja e tyre në Republikën e Shqipërisë)

Nr.	SHKK	Qyteti	Adresa e saktë

Formulari nr. 6 (vazhdim i aneksit nr. 1)
Plani i përmbledhur i veprimtarisë

Në këtë plan duhet të paraqiten të dhënat e kërkuara gjatë procesit të licencimit të subjekteve pranë Autoritetit Mbikëqyrës sipas akteve të miratuara prej tij për këtë qëllim.

ANEKSI 2

Kërkesë për pajisje me certifikatë të re për sigurimin e depozitave

Kërkojmë pajisjen me certifikatë të re për sigurimin e depozitave në rast të ndryshimit të emrit ose në rast të riorganizimit të SHKK-së.

Shkaku i ndryshimit të emrit

□ Riorganizim: □ Ndryshim emri

Shëno më poshtë llojin e riorganizimit:

□ Bashkim me përthithje

□ Bashkim me krijim

□ Ndarje me krijim

□ Ndarje me përthithje

Emri i shoqërisë së kursim-kreditit të propozuar

Shoqëria e kursim-kreditit:_____

_____

Adresa:

_____,

Shqipëri (qyteti) (rrethi)

Me anë të kësaj kërkese i drejtohemi Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, duke i vënë në dispozicion çdo informacion të kërkuar prej saj, për të na pajisur me vërtetim për përmbushjen e kushteve/certifikatë të re për sigurimin e depozitave me emërtimin e ri.

_____

Kërkuesit

_____

_____

_____

_____

Shënim. Kërkesa e shoqëruar me dokumentet dhe me formularët e kërkuar në mbështetje të këtij udhëzimi dërgohen në adresën e mëposhtme:

Agjencia e Sigurimit të Depozitave

Rruga e Elbasanit

Pallati EDIL Al-IT, nr. 317, kodi postal 1010

Tiranë, Shqipëri

Kryetari i Këshillit Drejtues të SHKK-së

(emër, mbiemër, firmë)

ANEKSI 3

Regjistri elektronik i detyrimeve depozitë të SHKK-së

SHKK-të mbajnë informacione dhe të dhëna të sakta e të detajuara për depozitat dhe depozituesit si vijon:

- Mban dhe siguron me një kod të vetëm (unik) çdo depozitues me këto të dhëna të detyrueshme (në sistemin elektronik të SHKK-së dhe në letër):
- Për individët: emër, mbiemër, atësi, gjini, lloji i mjetit të identifikimit, numër të mjetit të identifikimit, **numër personal**, datëlindjen, adresën e depozituesit;
- Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare: **numri unik i identifikimit të subjektit** (NUIS) data e regjistrimit, emërtimi i subjektit, forma ligjore;
- Mban dhe siguron në çdo rast evidentimin me një shenjë të veçantë në sistemet elektronike të informacionit të depozitave kolateral ose të vendosura si garanci dhe të dhënat analitike të kredive të SHKK-së për të cilat këto depozita janë barrësuar;
- Mban dhe siguron në çdo rast evidentimin në sistemet elektronike të informacionit të të dhënave analitike për kreditë që ka çdo depozitues në SHKK;
- Mban dhe siguron në çdo rast evidentimin me një shenjë të veçantë në sistemet elektronike të informacionit të depozitave të vendosura në përfitim të të tretëve me/pa kusht dhe afat përfitimi me të dhënat analitike të kontratave përkatëse;
- Mban dhe siguron identifikimin dhe gjurmimin, nëse dërgesat dhe instrumentet e pagesave (p.sh., urdhër në arkë, transferta ndërbankare, transferta nëpërmjet internetit, e të tjera transferta elektronike) janë të bëra nëpërmjet pagesave *cash* ose duke debituar llogarinë e depozitës. Kjo gatishmëri është në funksion të administrimit e rregullimeve që lidhen me balancat e depozitave, me dërgesat pezull dhe faturat gjendje - të pagueshme;

- Mban dhe siguron gjurmimin nëse çeqet e kredituara nga llogaritë e depozitave janë ekzekutuar (ose imazhi i çeqeve të dëmtuara, është dërguar) për klering. Ky informacion përcakton nëse shumat e depozitave të siguruara duhet të korrigjohen për efekt të çeqeve të paekzekutuara për klering dhe çeqet e kthyera mbrapsht.

ANEKSI 4

Parametrat teknikë që duhet të plotësojë dhe raportet që duhet të gjenerojë sistemi informatik i SHKK-së

Sistemi informatik i shoqërisë së kursim-kreditit duhet të mundësojë në çdo kohë, vendosjen e parametrave të mëposhtëm:

- shumën e mbulimit;
- kursin zyrtar të këmbimit në ditën e vlerësimit;
- kodin unik të identifikimit të depozituesit;
- të gjitha kategoritë e produktit depozitë për depozituesin subjekt të skemës;
- të gjitha kategoritë e produktit kredi për depozituesin subjekt të skemës;
- detyrimet e tjera të depozituesit ndaj të tretëve;
- kushtet përjashtuese sipas nenit 32, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar.

Gjithashtu, sistemi informatik duhet të mundësojë në çdo kohë gjenerimin e raporteve të mëposhtme:

- pozicionin e çdo depozituesi (individ, tregtar, shoqëri tregtare) të SHKK-së lidhur me depozitat e tij (secilën nga depozitat dhe të marra së bashku);
- detyrimet ndaj SHKK-së (kredi, overdraft, çdo detyrim më vete, si dhe të marra së bashku);
- pozicionin neto të tij (depozita/kredi, të drejta/detyrime në vonesë);
- listën e plotë të depozituesve të SHKK-së, që janë subjekt i skemës, së bashku me shumën përkatëse të depozitave të agreguara;
- listën e depozituesve të SHKK-së që nuk janë subjekt i skemës, sipas nenit 32 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar;
- listën e depozitave që nuk përfshihen në skemën e sigurimit të depozitave, sipas nenit 32 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar;
- konvertimin në lekë të të gjitha depozitave në monedhë të huaj me kursin zyrtar të këmbimit i përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës në ditën e vlerësimit kërkuar nga Agjencia;
- evidentimi i depozitave kolateral dhe i depozitave të vendosura në përfitim të të tretëve;
- listën e depozituesve që kanë një detyrim kundrejt SHKK-së, me shumën përkatëse të kredisë që ata kanë;
- listën e depozituesve që janë subjekt i skemës pas bashkimit të cilësive të debitorit dhe kreditorit në një të vetëm, e shoqëruar me shumën përkatëse të depozitave të tyre krahasuar me nivelin e mbulimit;
- listën e depozituesve me shumën e kësteve të papaguara në afat që burojnë nga marrëdhënia kreditore e depozituesit me subjektin;
- listën e të gjithë klientëve aktivë, si dhe klientëve dormant me vlerë më të madhe se zero;
- raporte të ndryshme statistikore në varësi të situatave të ndryshme, që do të paraqiten.

ANEKSI 5

Klauzola e pëlqimit paraprak si pjesë e kontratës së depozitës

Nëpërmjet kontratës së depozitës deklaroj se i gjithë informacioni që kam dhënë është i saktë dhe i plotë.

Duke kuptuar se, të dhënat e mia identifikuese dhe financiare të ruajtura në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin profesional, si dhe për faktin se SHKK-ja (emri i SHKK-së) /dega (emri i degës) _____ dhe Agjencia në kuadër të Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim kanë marrë të gjithat masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave të mësipërme:

Autorizoj Agjencinë e Sigurimit të Depozitave që, për qëllimet që përfshijnë:

1. Vlerësimin e formularit të depozitimit të vlerave monetare;
2. Vlerësimin e besueshmërisë time si depozitues ose përfitues i depozitës;

të njihen me detyrimet depozitë të SHKK-së/degës së saj ndaj meje, nëpërmjet përpunimit të autorizuar të të dhënave/informacionit të Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim, në mënyrë që të vlerësojë sasinë e detyrimeve financiare, nga SHKK-ja në të cilën janë depozituar vlerat e mia monetare. Gjithashtu, jap pëlqimin tim që SHKK-ja (emri i SHKK-së) /dega e saj, të përdorë të dhënat e mia identifikuese dhe financiare që mbahen në regjistrin elektronik të tyre, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim të Agjencisë.

ANEKSI 6

Formulari i kërkesës për përdorues në sistemin informatik për raportim dhe kompensim

FORMULARI I KËRKESËS PËR PËRDORUES

Ju lutem plotësoni këtë formular për të krijuar një përdorues të ri ose për të ndryshuar profilin e një përdoruesi ekzistues.

Për:	**Agjencia e Sigurimit të Depozitave** **Sektori i Teknologjisë së Informacionit**

Nga SHKK-ja/: _____	**Data e kërkesës: __/__/____** **(dd/mm/vvvv)**

Përdoruesve të mëposhtëm u jepen të drejtat në sistem sipas tabelës:

Emri/mbiemri i përdoruesit	Ngarkon të dhëna	Kërkon informacion
	☐	☐
	☐	☐
	☐	☐
	☐	☐
	☐	☐
	☐	☐
	☐	☐
	☐	☐
	☐	☐
	☐	☐
	☐	☐
	☐	☐

Për SHKK-në **Autorizuesi i kërkesës** **(_____)**	**Për AGJENCINË** **Autorizuesi i kërkesës** **(_____)**

ANEKSI 7

Deklarata e përputhshmërisë[1]

Me anë të kësaj shkrese deklarojmë se informacioni i dhënë në formatin standard të skedarëve u përgatit dhe u paraqit në Agjenci në përputhje me kërkesat e ligjit për sigurimin e depozitave, i ndryshuar, dhe të udhëzimit për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit.

Njësia që e përgatit informacionin dhe njësia që e monitoron këtë informacion sigurojnë vërtetësinë e regjistrimit të transaksioneve, dhe se informacioni i dhënë Agjenci në Formatin Standard të Skedarëve, në dijeninë e tyre më të mirë është i vërtetë dhe i saktë.

Sistemet e detyrimeve depozitë të SHKK-së/ ndaj depozituesve përputhen me kërkesat minimale për sistemet e detyrimeve depozite të detajuara në udhëzimin për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit.

Për SHKK-në	**Për SHKK-në**
Drejtuesi i njësisë prodhuese	**Drejtuesi i njësisë monitoruese**
(_____)	**(_____)**

[1] Kjo deklaratë dërgohet e nënshkruar, e vulosur dhe e skanuar në adresën elektronike sskd_shkk@asd.gov.al, brenda datës 15 të çdo muaji.

ANEKSI 8

Formulari 1
Mënyrat kryesore për informimin e publikut

SHKK-të që aplikojnë për t'u pranuar në skemën e sigurimit të depozitave, në zbatim të kritereve të ligjit duhet të plotësojnë kushtet për informimin e publikut si më poshtë:

1. Të përfshijnë në kushtet e përgjithshme të punës dhe ato të veçanta për depozitat informacionin mbi:

- sigurimin e depozitës (p.sh. informacionin mbi depozituesit dhe depozitat subjekt i skemës së sigurimit të depozitave, shumën e sigurimit etj.);
- masën e kompensimit nga Agjencia;
- kushtet dhe afatet e pagimit të kompensimit;
- procedurat e sigurimit dhe kompensimit të depozitës;
- rolin dhe qëllimin e veprimtarisë së Agjencisë;

2. Informacioni sipas pikës 1 shpallet në mjediset publike të SHKK-së.

3. Të ekspozojnë në vende të dukshme adezivët me logon e ASD-së.

4. Të shpërndajnë fletëpalosjet, broshurat dhe materialet e tjera promovuese të dërguara nga Agjencia, në të gjitha SHKK-të, dhe degët e tyre, si dhe t'i publikojnë ato në faqen e internetit të SHKK-së.

5. Të përfshijnë linkun ndërlidhës të faqes së internetit të Agjencisë në faqen e internetit të SHKK-së.

6. Të përfshijnë në kontratën e depozitës një aneks të veçantë për informimin mbi sigurimin e depozitës, i cili i bashkëlidhet kontratës, sipas modelit të përcaktuar në këtë aneks.

7. Të përfshijnë shënimin në lidhje me sigurimin e depozitës nga Agjencia në formatin e pasqyrave të depozitave, sipas tekstit të përcaktuar në këtë aneks.

8. Nuk lejohet shpërndarja e materialeve informuese apo të tjera, të cilat ofrojnë informacion mbi Agjencinë apo skemën e sigurimit të depozitave pa marrë më parë miratimin për përdorimin e tyre nga Agjencia.

Formulari 2 (vazhdim i aneksit nr. 8)
Aneks i kontratës së depozitës për informimin e publikut

Nëse një depozitë që është e rregullt dhe e pagueshme, nuk paguhet nga një SHKK për arsye të cilat lidhen direkt me gjendjen e saj financiare, depozituesit paguhen/kompensohen nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Depozitat e znj./z./subjekti tregtar_____ janë të siguruara dhe kompensohen nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

Ky kompensim arrin shumën prej 2,000,000 lekësh për SHKK-në. Kjo do të thotë që të gjitha depozitat në të njëjtën SHKK janë agreguar që të llogaritet kufiri i mbulimit/kompensimit. Nëse p.sh. një depozitues ka një depozitë me afat prej 1,500,000 lekë dhe një depozitë pa afat prej 6,500,000 lekësh, atij ose asaj do t'i kompensohet vetëm 2,000,000 lekë.

Në rastet e depozitave të përbashkëta me të drejta të njëjta, limiti prej 2,000,000 lekësh zbatohet për secilin depozitues.

Në rastin e depozitave me person të autorizuar, sigurohet dhe kompensohet vetëm titullari i depozitës.

Nëse ju jeni një individ që keni llogari personale dhe llogari të biznesit tuaj në të njëjtën SHKK. Ju do të kompensoheni deri në 2,000,000 lekë për secilën prej tyre.

Nëse në ditën e ndërhyrjes depozituesi ka në subjektin e siguruar një depozitë dhe një kredi, depozita e siguruar krahasohet me nivelin 2,000,000 (dy milionë) lekë dhe prej saj zbritet shuma e detyrimeve që rezultojnë në vonesë shlyerjeje në ditën e ndërhyrjes. Shuma e gjetur kompensohet.

Të gjitha depozitat që janë në monedhë të huaj, konvertohen në lekë me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë, në ditën e kalimit të SHKK-së në likuidim.

Në përgjithësi të gjithë depozituesit, individë, tregtarë dhe shoqëri tregtare, janë të mbrojtur nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Të gjitha përjashtimet nga kjo mbrojtje janë të përcaktuara në ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar, dhe mund të gjenden në faqen zyrtare të Agjencisë, www.asd.gov.al. SHKK-ja juaj, gjithashtu, mund t'iu informojë për çdo hollësi të mëtejshme në lidhje me sigurimin ose jo të depozitës suaj.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave, me adresë: Rruga e Elbasanit, pallati EDIL AL-IT, nr. 317, kodi postar 1010, Tiranë, Shqipëri, telefon +355 4 362 989, 347 298, faqja zyrtare www.asd.gov.al, është përgjegjëse për realizimin e procesit të kompensimit brenda tre muajve.

Nëse nuk jeni kompensuar brenda këtij afati, duhet të kontaktoni me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave.

Depozita juaj është e siguruar nga një skemë e sigurimit të depozitave, gjë që do të thotë që të gjitha SHKK-të janë anëtare të kësaj skeme dhe ndihmojnë njëra-tjetrën për të shmangur falimentimin e ndonjë SHKK-je. Por, sidoqoftë, nëse falimentimi i ndonjë SHKK-je do të ndodhë, depozitat tuaja do të kompensohen deri në 2,000,000 lekë.

Formulari 3 (vazhdim i aneksit nr. 8)
Formulimi i shënimit në pasqyrën e depozitës dhe fletëpalosjet e depozitave

Depozita në shoqëritë e kursim-kreditit sigurohet deri në shumën 2,000,000 (dy milionë) lekë nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Për informacione të tjera në lidhje me skemën e sigurimit të depozitave, ju lutem pyesni në degën tuaj lokale në SHKK ose drejtohuni në faqen e internetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave: www.asd.gov.al.

ANEKSI 9

Vlerësimi i shumës së depozitave të siguruara

SHKK-ja, në vlerësimin e shumës së depozitave të siguruara, përcakton depozitat depozituesve që janë subjekt i skemës, në përputhje me nenin 3, pika 14, nenet 26, 31, 32, dhe 33, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar.

Rasti i parë:

- Depozituesi ka vetëm një depozitë në lekë:

Në qoftë se kjo depozitë është më e vogël, se 2,000,000 (dy milionë) lekë, ajo sigurohet e plotë (përfshihet interesi ditor i llogaritur në ditën e vlerësimit të primit);

në qoftë se është më e madhe se 2,000,000 lekë, sigurohet pjesa deri në nivelin 2,000,000 lekë;

- Depozituesi ka disa depozita, të cilat janë në lekë dhe në monedhë të huaj. Depozitat në monedhë të huaj konvertohen në lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit të Autoritetit Mbikëqyrës në ditën e vlerësimit, dhe më pas të gjitha depozitat agregohen. Shuma e gjetur nga agregimi, krahasohet me nivelin 2,000,000 lekë dhe sigurohet pjesa e depozitës deri në nivelin e mbulimit;

- Depozituesi ka disa depozita dhe një ose më shumë depozita të përbashkëta me të drejta të plota. Në këtë rast bashkohen të gjitha depozitat duke shtuar edhe pjesën korresponduese të depozitës të përbashkët, e cila ndahet në pjesë të barabarta midis titullarëve të saj, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në kushtet e vendosjes së depozitës.

Për konkretizim, në rast se një depozitues ka një depozitë të përbashkët me një të afërmin e tij, një depozitë individuale dhe një tjetër të përbashkët me dy persona të tjerë ose më shumë, atëherë ky depozitues është disponues i gjysmës së shumës së depozitës që ka me të afërmin e tij, i depozitës individuale dhe i një të tretës së depozitës së përbashkët me personat e tjerë, ato bashkohen dhe sigurohet pjesa deri në 2,000,000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

Depozitat e një individi nuk bashkohen me depozitat në të cilat ai është titullar si tregtar ose si përfaqësues ligjor i një shoqërie tregtare.

Rasti i dytë: Depozituesi ka depozitë të vendosur si garanci për një person të tretë. Në këtë rast e drejta për sigurim të depozitës i njihet titullarit të depozitës.

Në rast se depozituesi ka edhe depozita të tjera në SHKK këto agregohen me depozitën e vendosur si garanci dhe sigurohet pjesa deri në 2,000,000 (dy milionë) lekë.

Rasti i tretë: Depozituesi ka depozitë të vendosur me kusht ose me afat në përfitim të një personi të tretë, të drejtat për sigurim të depozitës i njihen titullarit të depozitës deri në plotësimin e afatit ose kushtit përkatës. Në të kundërt, e drejta për sigurim i takon përfituesit të depozitës. Në rastin e depozitës të vendosur në përfitim të një treti pa kusht ose afat, e drejta për sigurimin e depozitës i njihet këtij të fundit. Në rastin e depozitës së vendosur në përfitim të më shumë se një personi të tretë, zbatohen rregullat e parashikuara për depozitat e përbashkëta me të drejta të plota.

Në këtë rast zbatohet agregimi dhe sigurohet pjesa deri në 2,000,000 (dy milionë) lekë.

ANEKSI 10

Vlerësimi i shumës së kompensimit

SHKK-ja, në vlerësimin e shumës së kompensimit, përcakton depozitat që janë subjekt i skemës të sigurimit të depozitave, në përputhje me nenin 3, pika 14, nenet 26, 31, 32, 33, pika 1, shkronja "b", 38, 39, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar.

Rasti i parë:

- Depozituesi ka vetëm një depozitë në lekë:

Në qoftë se kjo depozitë është më e vogël, se 2,000,000 (dy milionë) lekë, ajo kompensohet e plotë (përfshihet interesi ditor i llogaritur në ditën e ndërhyrjes);

Në qoftë se është më e madhe se 2,000,000 lekë, kompensohet pjesa deri në nivelin 2,000,000 lekë;

- Depozituesi ka disa depozita, të cilat janë në lekë dhe në monedhë të huaj. Depozitat në monedhë të huaj konvertohen në lekë sipas kursit zyrtar të Autoritetit Mbikëqyrës në ditën e ndërhyrjes, dhe më pas të gjitha depozitat agregohen. Shuma e gjetur nga agregimi, krahasohet me nivelin 2,000,000 lekë dhe kompensohet pjesa e depozitës deri në nivelin e mbulimit;

- Depozituesi ka disa depozita dhe një ose më shumë depozita të përbashkëta me të drejta të plota. Në këtë rast agregimi përfshin të gjitha depozitat duke shtuar edhe pjesën korresponduese të depozitës të përbashkët, e cila ndahet në pjesë të barabarta midis titullarëve të saj, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në kushtet e vendosjes së depozitës.

Për konkretizim, në rast se një depozitues ka një depozitë të përbashkët me një të afërmin e tij, një depozitë individuale dhe një tjetër të përbashkët me dy persona të tjerë ose më shumë, atëherë ky depozitues është disponues i gjysmës së shumës së depozitës që ka me të afërmin e tij, i depozitës individuale dhe i një të tretës, së depozitës së përbashkët me personat e tjerë, ato agregohen dhe kompensohet pjesa deri në 2,000,000 (dy milionë) lekë;

- Depozituesi ka në SHKK një (ose disa) depozitë dhe një (ose disa) kredi. Depozita e siguruar (shuma e tyre nëse janë disa) krahasohet me nivelin 2,000,000 (dy milionë) lekë dhe prej saj (shumës) zbritet shuma e detyrimeve që rezultojnë në vonesë shlyerjeje në ditën e ndërhyrjes. Shuma e gjetur kompensohet.

Depozitat e një individi nuk bashkohen me depozitat në të cilat ai është titullar si tregtar ose si përfaqësues ligjor i një shoqërie tregtare.

Rasti i dytë: Depozituesi ka depozitë të vendosur si garanci për një person të tretë anëtar i SHKK-së. Titullarit i kompensohet kjo depozitë në rast se depozita është çliruar nga detyrimi i garancisë.

Rasti i tretë: Kur depozituesi ka depozitë të vendosur me kusht ose me afat në përfitim të një personi të tretë, ai kompensohet nëse nuk është plotësuar afati ose kushti përkatës.

Në rastin e depozitës të vendosur në përfitim të një treti pa kusht ose afat, kjo depozitë i kompensohet përfituesit. Në rastin e depozitës së vendosur në përfitim të më shumë se një personi të tretë, zbatohen rregullat e parashikuara për depozitat e përbashkëta me të drejta të plota. Në këtë rast zbatohet agregimi dhe kompensohet pjesa deri në 2,000,000 (dy milionë) lekë.

ANEKSI 11

Mënyra e përllogaritjes së primit të vitit të parë të aktivitetit

Përllogarisim për SHKK-në ANONIM, për shembull të licencuar më datë 10 nëntor $20XX_i$:

Primi i vitit të parë të aktivitetit është i barabartë me 0,3% të mesatares aritmetike të shumës të depozitave të siguruara, që janë regjistruar në fund të çdo dite pune përgjatë 12 muajve të parë të veprimtarisë të SHKK-së.

Shënojmë me:

"Mj" - shumën e depozitave të siguruara në lekë për secilën ditë pune të vitit të parë të aktivitetit të SHKK-së (10 nëntor $20XX_i$ – 9 nëntor $20XX_{i+1}$);

"j" - dita e punës së vitit të parë të aktivitetit të SHKK-së, sipas kalendarit të Bankës së Shqipërisë nga 1,2,3 ....n;

"d"- numri i ditëve të punës që ka viti i parë i aktivitetit të SHKK-së;

A - mesatarja aritmetike e shumës së depozitave të siguruara, që janë regjistruar në SHKK-në fund të çdo dite pune të vitit të parë të aktivitetit të saj;

P - primi i vitit të parë të aktivitetit.

Vlerësojmë mesataren aritmetike të depozitave për vitin e parë të aktivitetit:

$$\frac{M_1 + M_2 + M_3 + M_4 + \ldots\ldots\ldots M_n}{d} = A \text{ lekë}$$

Primi i vitit të parë të aktivitetit, që do të paguajë SHKK-ja ANONIM, është:

"A" * 0.3% = P lekë

Primi i vitit të parë të aktivitetit vjetor paguhet njëherësh sipas njoftimit të Agjencisë.

* SHKK-ja për efekt të transparencës të verifikimit të mënyrës së llogaritjes së primit të sigurimit, duhet të evidentojë në mënyrë të dukshme të gjitha hallkat e ekzekutimit të programit për llogaritjen e primit, nga momenti fillestar i të dhënave analitike për depozitat dhe kreditë, deri në shumën përfundimtare të primit të sigurimit të depozitave.

ANEKSI 12

Mënyra e përllogaritjes së primit të parë tremujor pas vitit të parë të aktivitetit*

Primi për SHKK-në ANONIM për periudhën 10 nëntor $20XX_{i+1}$– 31 dhjetor $20XX_{i+1}$ përllogaritet proporcionalisht, si vijon.

1. **Hapi i parë**: Përllogaritet primi për tremujorin 1 tetor $20XX_{i+1}$– 31 dhjetor $20XX_{i+1}$ me 0,075% të mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara që janë regjistruar në SHKK-në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm.

Shënojmë me:

"$M_{k/g/sh}$"- shumën e depozitave të siguruara në lekë për secilën ditë të fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm (korrik, gusht, shtator).

"d" - numri i ditëve të punës që ka tremujori 1 tetor $20XX_{i+1}$ – 31 dhjetor $20XX_{i+1}$ sipas kalendarit të Bankës së Shqipërisë.

"d_1" - numri i ditëve të punës për periudhën 10 nëntor $20XX_{i+1}$ – 31 dhjetor $20XX_{i+1}$ sipas kalendarit të Bankës së Shqipërisë.

A - mesatarja aritmetike e shumës së depozitave të siguruara, që janë regjistruar në SHKK për secilën ditë të fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm.

$$\frac{M_k + M_g + M_{sh}}{3} = \text{A lekë}$$

Primi i tremujorit 1 tetor $20XX_{i+1}$ – 31 dhjetor $20XX_{i+1}$ është i barabartë me:

P (lekë) = "A" * 0.075%

2. **Hapi i dytë**: Primi për periudhën 10 nëntor $20XX_{i+1}$ – 31 $20XX_{i+1}$ dhjetor përllogaritet si vijon:

P_1 (lekë) = "P" * d1/d

Ky prim paguhet sipas njoftimit të Agjencisë.

* SHKK-ja për efekt të transparencës të verifikimit të mënyrës së llogaritjes së primit të sigurimit, duhet të evidentojë në mënyrë të dukshme të gjitha hallkat e ekzekutimit të programit për llogaritjen e primit, nga momenti fillestar i të dhënave analitike për depozitat dhe kreditë, deri në shumën përfundimtare të primit të sigurimit të depozitave.

ANEKSI 13

Shoqëria e kursim-kreditit

DEKLARATA E PRIMIT TREMUJOR
(datë/muaj/vit)

Në zbatim të nenit 35, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar, më poshtë iu paraqesim deklaratën e llogaritjes së primit tremujor për periudhën....

Përshkrimi

1. Mesatarja aritmetike e shumës së depozitave të siguruara, që janë të regjistruara në SHKK në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm. (Shuma në lekë)……..

2. Norma e primit në lekë……..

3. Primi (Shuma në lekë)……..

4. Periudha e sigurimit për të cilën paguhet……..

Në llogaritjen e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të sigurueshme janë marrë në konsideratë:

1. Teprica kreditore e llogarisë depozitë e të gjitha llojeve, dhe interesi i llogaritur, regjistruar në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm me përjashtim të depozitave sipas nenit 32 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar.
2. Konvertimi në lekë i gjithë llogarive depozitë në monedhë të huaj, duke aplikuar kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për çdo ditë pune, në ditën e vlerësimit.
3. Bashkimi i depozitave të siguruara të çdo depozituesi, të vendosura në disa llogari në një të vetme si dhe nivelimi i shumës me 2,000,000 lekë.

Në rastin kur primi i llogaritur dhe paguar për tremujorin e mëparshëm ka rezultuar me gabime, sipas verifikimit në vend të kryer nga Agjencia ose konstatimit nga vetë SHKK-ja, atëherë SHKK-ja deklaron primin e korrigjuar si vijon:

1. Shpjegim me tekst i pasaktësive/mangësive të korrigjuara)
2. Shtesa/zbritja që korrigjon mesataren aritmetike të shumës së depozitave të siguruara, për tremujorin e mëparshëm (shuma në lekë) 3 .....…….
3. Norma e primit.....
4. Shtesa/zbritja që korrigjon primin (në lekë).....
5. Periudha e sigurimit (për të cilën paguhet).....

ANEKSI 14

Klasifikimi i depozitave

Tabela 1

Klasifikimi i depozitave të agreguara të individëve/tregtarëve dhe shoqërive tregtare që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave

Muaji ... 000/lekë

Struktura e depozitave të individëve/tregtarëve dhe shoqërive tregtare	**Totali**	
	Nr.	**Shuma**
Deri – 100		
101–500 000		
500 001–1 000 000		
1 000 001–1 500 000		
1 500 001–2 000 000		
2 000 001–2 500 000		
2 500 001–3 000 000		
3 000 001–3 500 000		
Mbi 3 500 000		
TOTALI		

Tabela 2
Klasifikimi i depozitave në vlerë të agreguar

Të individëve/tregtarëve dhe shoqërive tregtare pas bashkimit të cilësive të debitorit dhe kreditorit në një të vetëm

Muaji ….		000/lekë
Struktura e depozitave të individëve/tregtarëve dhe shoqërive tregtare	**Totali**	
	Nr.	**Shuma**
Deri – 100		
101–500 000		
500 001–1 000 000		
1 000 001–1 500 000		
1 500 001–2 000 000		
2 000 001–2 500 000		
2 500 001–3 000 000		
3 000 000–3 500 000		
Mbi 3 500 000		
TOTALI		

Tabela 3

Klasifikimi sipas niveleve i depozitave të individëve/tregtarëve dhe shoqërive tregtare që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave

Muaji….. 000/lekë

Struktura e depozitave të individëve/tregtarëve dhe shoqërive tregtare	Totali	
	Nr.	Shuma
Deri – 100		
101–500 000		
500 001–1 000 000		
1 000 001–1 500 000		
1 500 001–2 000 000		
2 000 001–2 500 000		
2 500 001–3 000 000		
3 000 001–3 500 000		
Mbi 3 500 000		
TOTALI		

Për secilën valutë 000/lekë

Struktura e depozitave të individëve/tregtarëve dhe shoqërive tregtare	Totali	
	Nr.	Shuma
Deri – 100		
101–500 000		
500 001–1 000 000		
1 000 001–1 500 000		
1 500 001–2 000 000		
2 000 001–2 500 000		
2 500 001–3 000 000		
3 000 001–3 500 000		
Mbi 3 500 000		
TOTALI		

000/lekë

Totali i depozitave të SHKK-së sipas bilancit		Shuma

Tabela 4
Të dhëna për produktin depozitë

Për individë/tregtarë dhe shoqëri tregtare sipas kategorive në shumë dhe në numër*

000/lekë

Monedha	Llogari depozite pa afat me interes		Llogari depozite pa afat pa interes		Llogari depozite me afat me interes		Llogari depozite për garanci	
	Numri	***Shuma***	***Numri***	***Shuma***	***Numri***	***Shuma***	***Numri***	***Shuma***
ALL								
USD								
EURO								
GBP								
CHF								
CAD								
SEK								
AUD								
YEN								
DKK								
TRY								
Të tjera								

* Duhet të përfshihen të gjitha kategoritë e produktit depozitë, emërtimet e të cilave ndryshojnë në varësi të SHKK-së.

Shënim: Informacioni i këtij aneksi do të raportohet në tabela të veçanta për depozituesit individë dhe për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Ky informacion të përfshijë të gjitha depozitat/llogaritë së bashku me interesat, (nëse janë në monedhë të huaj - të konvertuara në lek sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë) për ditën e fundit të muajit. Raportimi sipas këtij aneksi kryhet me format elektronik "excel" në adresën elektronike sskd_shkk@asd.gov.al brenda datës 10 të çdo muaji.

Tabela 5
Anëtarët dhe depozituesit në SHKK

Nr.	Emërtimi	Numri	Shuma
1	Anëtarët e SHKK-së në total		
2	Anëtarët e SHKK-së që kanë depozita		
3	Anëtarët e SHKK-së që kanë kredi		
4	Anëtarët e SHKK-së që kanë kredi dhe depozita		

ANEKSI 15

Formularët e raportimit të treguesve rregullatorë:

Nr.	Emri i treguesit**	Kufijtë rregullatorë	Vlera në fund të muajit	Statusi*
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				

* në kolonën "Statusi" do të shënohet vetëm respektuar ose thyer sipas rastit.

**** kolona "Emri i treguesit" do të plotësohet në përputhje me aktet nënligjore të Autoritetit Mbikëqyrës.**

Ky formular do të plotësohet për çdo SHKK brenda datës 15 të çdo muaji. Për SHKK-të me thyerje të treguesve të kapitalit ose kredive me probleme, SHKK-ja duhet të paraqesë edhe deklaratën e primit shtesë.

ANEKSI 16

Shoqëria e kursim-kreditit …… ose

DEKLARATA E PRIMIT SHTESË
(datë/muaj/vit)

Në zbatim të nenit 66, pika 8 e ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar, më poshtë ju paraqesim deklaratën e përllogaritjes së primit shtesë

Përshkrimi

Ky prim shtesë duhet paguar nga SHKK-ja _____, me numër NIPT-i _____, për shkak të thyerjes së treguesit rregullator _____, në muajin _____ 20___.

Mesatarja aritmetike e shumës së depozitave të siguruara, që ka shërbyer si bazë për përllogaritjen e primit të fundit të paguar për tremujorin e _____ të vitit _____ është _____ lekë.

Primi i llogaritur për t'u paguar është $\frac{0.003}{12} \times$ _____ lekë = _____ lekë

Emri i SHKK-së _____

Adresa_____

Kryetari i Këshillit Drejtues të SHKK-së **Kryetari i komitetit mbikëqyrës të SHKK-së**

(emër, mbiemër, firmë) (emër, mbiemër, firmë)

ANEKSI 17

Formular raportimi tremujor

Të dhëna për SHKK-të

SHKK-ja	**Lloji i anëtarësisë***	**Adresa e selisë**	**Kryetari i këshillit**	**Kontakt për kryetarin e këshillit**	**Numri i anëtarëve**	**Numri i depozituesve**

*Shënim. Lloji i anëtarësisë nënkupton shpërndarjen sipas, p.sh., zonës gjeografike për SHKK-në me anëtarë një fshat, qendrës së punës për SHKK-të me anëtarë të një profesioni etj.

ANEKSI 18

Raporti mujor i përputhshmërisë të balancave të depozitave sipas bilancit të përgjithshëm me formatin e fluksit të depozitave të dërguar në sistemin informatik për raportim dhe kompensim

Emri i SHKK-së _____

në lekë

	A	B	C	D	
Nr. i klasave*	**Emërtimi**	**Sipas bilancit në datën dd/mm/20[vv]**	**Sipas raportimit në sistemin e Agjencisë në datën dd/mm/20[vv]**	**Diferencat**	**Sqarime për diferencat**
	Totali i depozitave të individëve				
	Totali i depozitave të tregtareve dhe shoqërive tregtare				

Përgatitur nga: **Departamenti ……**

Emri:

Pozicioni:

Data:

Përgatitur nga: **Departamenti .....**

Emri:

Pozicioni:

Data:

Raportimi sipas këtij aneksi kryhet me format elektronik *Excel* në adresën elektronike sskd_shkk@asd.gov.al brenda datës 15 të çdo muaji.

* kategoritë dhe klasat e produktit depozitë do të plotësohen në përputhje me informacionin e dërguar në sistemin raportues të unifikuar, në përputhje me aktet nënligjore të Autoritetit Mbikëqyrës.